	UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	1 / 6

Neni 1

Qëllimi i udhëzimit

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë metodat dhe procedurat e publikimeve dhe të pjesëmarrjes në aktivitetet shkencore të stafit akademik të Kolegjit Universitar “Bedër”.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky udhëzim rregullon aktivitetin e parashikuar në nenin 5 të këtij udhëzimi, të stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme (në rast se publikimet realizohen në emër të Kolegjit Universitar “Bedër”. Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen edhe për personelin administrativ, i cili përfshihet në aktivitetet e sipërpërmendura akademike.

Neni 3

(shfuqizohet me vendim senati nr.2, datë 15.07.2020)

Neni 4

Raporti i mbështetjes dhe funksionimi

(ndryshohet me vendim senati nr.2, datë 15.07.2020)

Aplikimet bëhen nëpërmjet plotësimit të formularit përkatës dhe dorëzimit të tij pranë departamentit i cili bën një vlerësim paraprak. Formularit të aplikimit i bashkëngjitet fotokopja e formularit të publikuar, kapaku i revistës dhe dokumente të tjera. Dokumentacioni që ka lidhje me aplikimin, i bashkëngjitet formularit të aplikimit dhe i dorëzohet administratorit nga njësia e interesuar. Aplikimi për dhënien e një çmimi mund të bëhet vetëm për punimet për të cilat është bërë aplikimi. Mund të bëhet aplikim edhe për publikimet e bëra një vit më parë dhe të miratuara për publikim. Administratori vlerëson kërkesën dhe merr vendim në lidhje me të. Publikimet që nuk janë botuar në emër të Kolegjit Universitar “Bedër” nuk mund të vlerësohen me çmim.

Për çdo vit akademik, Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar (Bedër) vendos për nivelin e kontributit për aktivitetet shkencore. Pas vlerësimit të departamentit dhe miratimit nga administratori të shpërblimeve për publikimet, bëhet pagesa duke u shumëzuar me pikët përkatëse sipas tabelës më poshtë. Pagesa pjesëtohet sipas numrit të autorëve.


Ata që kanë bërë publikime ose kanë marrë pjesë në veprimtarinë akademike me mbështetjen e Kolegjit Universitar “Bedër” nuk përfitojnë shpërblime për publikimet, sipas këtij udhëzimi.

Neni 5

Klasifikimi dhe pikët përkatëse të publikimeve shkencore dhe veprimtarive akademike

Klasifikimi dhe pikët përkatëse të publikimeve shkencore dhe veprimtarive akademike janë ilustruar në tabelën si më poshtë:

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	2 / 6

Lloji	Publikimi shkencor dhe veprimtaria akademike	Kodi	Pikët
A - Punime shkencore	Punime shkencore të publikuara në indeksin e citimit të publikimeve shkencore- Science Citation Index (SCI), Social Science Citation Index (SSCI) dhe Arts and Humanities Citation Index (AHCI), me juri	A1	650
	Punime shkencore të paraqitura në konferenca, kongrese, simpoziume ndërkombëtare dhe të publikuara në mënyrë të plotë në revista periodike, si SCI, SSCI dhe AHCI.	A2	350
	Punime shkencore të publikuara në revista me faktorin IMPACT, që skanohen nga indekse ndërkombëtare përveç SCI, SSCI dhe AHCI.	A3	300
	Punime shkencore të publikuara në revista të tjera të indeksuara ndërkombëtare, përveç SCI, SSCI dhe AHCI.	A4	200
	Punime shkencore të publikuara në revista të indeksuara ndërkombëtare që nuk skanohen, me juri dhe periodikë	A5	100
	Punime shkencore të publikuara në revista kombëtare me juri dhe periodikë	A6	50
B - Prezantime dhe publikime	Prezantime dhe publikime të artikujve të plotë, si folës i ftuar në konferenca, kongrese si dhe simpoziume ndërkombëtare	B1	200
	Prezantime dhe publikime të abstrakteve, si folës i ftuar në konferenca, kongrese si dhe simpoziume ndërkombëtare	B2	100
	Artikuj të plotë të publikuar në libra dhe të prezantuar në kongrese si dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare	B3	100
	Abstrakte të publikuara në libra dhe të prezantuara në konferenca, kongrese si dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare	B4	50
	Postera që ekspozohen dhe që u publikohet i gjithë teksti në konferenca, kongrese si dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare	B5	50
	Posterat që ekspozohen dhe që u publikohet përmbledhja në konferenca, kongrese si dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare	B6	20
	Artikuj të pa publikuar por të prezantuar në konferenca, kongrese si dhe simpoziume kombëtare e ndërkombëtare	B7	20


Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati

UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	3 / 6


C- Librat	Libra origjinalë të publikuar në gjuhën angleze nga shtëpi botuese ndërkombëtare (më e pakta 50.000 fjalë)	C1	1000
	Libra origjinalë të publikuar nga shtëpi botuese kombëtare (më e pakta 50.000 fjalë)	C2	500
	Shkrimi i një kapitulli në një libër origjinal ndërkombëtar dhe publikim doracaku	C3	200
	Publikimi i librave në emër të institucionit (më e pakta 50.000 fjalë)	C4	300
	Përkthim libri dhe shtypja e tij në institucion	C5	200
	Libër mësimor i publikuar në emër të institucionit	C6	150
	Materialet e prezantimit të mësimave të publikuara me video(10-20 min) në faqen ëeb të institucionit si dhe prezantimet e të gjitha javëve të një lënde mësimore	C7	100
	Materialet e prezantimit të mësimave të publikuara me video(10-20 min) në faqen ëeb të institucionit si dhe prezantimet e të gjitha javëve të një lënde mësimore në mënyrë të përditësuar	C8	100
D-Editor dhe juri	Të kryejë detyrën e redaktorit në revista periodike dhe me juri, të indeksuara në indeksin e citimit të publikimeve shkencore që skanohen nga Science Citation Index (SCI), Social Science Citation Index (SSCI) dhe Arts and Humanities Citation Index (AHCI), (vjetore)	D1	500
	Të kryejë detyrën e kryeredaktorit ose redaktorit në revista periodike dhe që skanohen nga indekse ndërkombëtare, përveç SCI, SSCI dhe AHCI (vjetore)	D2	150
	Të kryejë detyrën e zëvendës redaktorit në revista periodike ndërkombëtare (vjetore) dhe që skanohen nga indekse ndërkombëtare, përveç SCI, SSCI dhe AHCI (vjetore)	D3	100
	Të kryejë detyrën e kryeredaktorit ose zëvendës redaktorit në revista periodike kombëtare me juri (vjetore)	D4	150
	Të kryejë detyrën e zëvendës redaktorit në revista periodike kombëtare me juri (vjetore)	D5	100
	Të kryejë detyrën e redaktorit në revistat profesionale të	D6	100

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	4 / 6

	publikuara nga institucioni(vjetore)		
	Të jetë pjesë e jurisë së këshillit të redaktorëve në revista periodike kombëtare e ndërkombëtare me juri (vjetore)	D7	50
E- Patenta			
	Shpikje dhe Patenta të rregjistruara në emër të Universitetit jashtë shtetit.	E1	3000
	Shpikje dhe Patenta të rregjistruara në emër të Universitetit brenda Shqipërisë.	E2	1000
F-Projekte kërkimore			
	Udhëheqja e një projekti kërkimor ndërkombëtar dhe shkrimi i raportit përfundimtar	F1	500
	Pjesëmarrja si asistent kërkimor në një projekt kërkimor ndërkombëtar dhe përgatitja e raportit përfundimtar	F2	100
	Pjesëmarrja si drejtues në një projekt kërkimor me fonde të destinuar për kërkime kombëtare ose ndërkombëtare dhe përgatitja e raportit përfundimtar	F3	200
	Pjesëmarrja si asistent kërkimor në një projekt kërkimor me fonde të destinuar për kërkime kombëtare ose ndërkombëtare dhe përgatitja e raportit përfundimtar	F4	50
G-Kontributi social			
	Të jetë kryetar i kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve ndërkombëtare	G1	300
	Të jetë sekretar i kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve ndërkombëtare ose të përgatitsë raportin përfundimtar dhe të jetë redaktor i librit të raporteve	G2	150
	Të jetë kryetar i kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve kombëtare	G3	200
	Të jetë sekretar i kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve kombëtare ose të përgatitsë raportin përfundimtar dhe të jetë redaktor i librit të raporteve	G4	100
	Këshillimi i institucioneve publike ose private në emër të institucionit, shkrimi i raportit teknik ose i opinionit	G5	100
	Shkrimi në fushën përkatëse profesionale në organet e mediave ndërkombëtare	G6	30

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati

	UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	5 / 6

	Shkrimi në fushën përkatëse profesionale në organet e mediave kombëtare	G7	20
	Pjesëmarrja si folës në fushën profesionale përkatëse në televizion ose radio (te paktën 10 min)	G8	50
H- Marrëdhënie ndërkombëta re			
	Të menaxhojë marrëdhëniet me institucione akreditimi kombëtare e ndërkombëtare dhe të mundësojë akreditimin (Të jetë kryetar ose nënkryetar në rang Universiteti)	H1	300
	Të menaxhojë marrëdhëniet me institucione akreditimi kombëtare e ndërkombëtare dhe të mundësojë akreditimin (Të jetë kryetar ose nënkryetar në rang departamenti)	H2	200
	Të menaxhojë marrëdhëniet me institucione akreditimi kombëtare e ndërkombëtare dhe të mundësojë akreditimin (Të marrë pjesë në këshill në rang Universiteti dhe departamenti)	H3	50


Në veçanti në shkencat kryesore, për publikimet në revistat me faktorë të lartë ndikimi duhet të merret paraprakisht vlerësimi i komisionit.

Në një konferencë, kongres, simpozium mund të vlerësohen e shumta dy punime nga i njëjti pjesëmarrës.

Normat e inkurajimit sipas numrit të shkrimtarëve:

Numri i shkrimtarëve të veprës	Emri i parë %	Emri i dytë %	Emri i tretë %	Emri i katërt %	Emri i pestë %	Emri i gjashtë %	Emri i shtatë %	Emri i tetë %	Emri i nëntë %	Emri i dhjetë %	Emri i njëmbëdhjetë dhe në vazhdim %
Me 1 shkrimtar	100										
Me 2 shkrimtar	60	40									
Me 3 shkrimtar	50	30	20								
Me 4 shkrimtar	40	30	15	15							
Me 5 shkrimtar	35	20	15	15	15						

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati

 KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	UDHEZIM PËR NXITJEN E PUBLIKIMEVE DHE KËRKIMIT SHKENCOR				
	Kodi i Dokumentit	Data e Publikimit	Nr. i Përditësimit	Data e Perditësimit	Faqe/Total
	BU-DIR-004-AL	01.10.2012	1	15.07.2020	6 / 6

Me 6 shkrimtar	30	20	15	15	10	10					
Me 7 shkrimtar	30	20	15	15	10	5	5				
Me 8 shkrimtar	30	20	15	15	5	5	5	5			
Me 9 shkrimtar	30	20	15	10	5	5	5	5	5		
Me 10 shkrimtar	30	20	10	10	5	5	5	5	5	5	
Me 11 shkrimtar dhe në vazhdim	30	20	10	10	Përqindja e mbetur ndahet në mënyrë të barabartë						

Neni 6

Vlerësimi i pjesëmarrjes në veprimtaritë shkencore (ndryshohet me vendim senati nr.2, datë 15.07.2020)

Me qëllim që stafi akademik të marrë pjesë në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, ky i fundit përcakton edhe buxhetin. Këtu përfshihen kongrese, simpoziume, pjesëmarrje në seminare, punime në atelie, programi i shkëmbimit të studenteve, kurset profesionale dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Anëtari i stafit akademik duhet të marrë pjesë personalisht në program dhe emri i tij të jetë shënuar në program për t'u vlerësuar sipas këtij neni. Pjesëmarrjet ose punimet e posterave dhe aktivitete të ngjashme me këto nuk mbështeten nga institucioni. Për aktivitetet akademike mund të merret mbështetje vetëm nga një burim. Pjesëmarrësit aplikojnë nëpërmjet një formulari. Në lidhje me mbështetjen financiare duhet të merret paraprakisht mendimi pozitiv i Departamentit dhe i Administratorit. Mbështetja mund të kërkohet, të shumtën dy herë gjatë një viti akademik. I jepet përparësi personelit, i cili nuk ka kërkuar mbështetje të mëparshme.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tij në Senatin Akademik.

Neni 7

Zbatimi i këtij udhëzimi sigurohet nga rektori.

Njësia Përpiluese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor	Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë	Senati